



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT



Ë-buletin

Gusht, 2017

**Punëtori 3 ditore e Këshillit Drejtues të SBASHK-ut
Detyra konkrete të angazhimit në shërbim të anëtarësisë**



Me qëllim që të bëhen përgatitje sa më të mira për t'u përballur me sfidat dhe të konkretizim të detyrave dhe angazhimeve në shërbim të anëtarësisë Këshilli Drejtues në një punëtori tri ditore ka punuar në përgatitjen e e një plani të aktivitetit lidhur me hapat konkret që duhet ndërmarrë në realizimin në plotëni të Kontratës Kolektive të Arsimit dhe të ndërrimeve e plotësimeve në Statut.

Duke hapur punimet e kësaj punëtorie kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj ka apeluar të anëtarët e Këshillit ... (faqe 4)

Vit i suksesshëm zgjedhor në SBASHK

Pas zgjedhjeve në shoqata nisi agjenda e zgjedhjeve në nivel komunash



Sipas raporteve të dorëzuara në selinë e SBASHK-ut dhe bazuar në raportimet e kryetarëve të SAF(faqe 5)

SBASHK forcon bashkëpunimin me Sindikatën e Pavarur të Arsimit shqiptar

Gatishmëri e dy anshme për angazhime të përbashkëta sindikale

SBASHK-u ka bashkëpunim të shkëlqyer me(faqe 7)

Intervistë me edukatoren dhe sindikalisten Flora Shabanaj

SBASHK-u të vazhdojë me angazhimet dhe sukseset

Flora Shabanaj është edukatore në Institucionin parashkollor "Foleja".

"Duke u nisur nga fakti se. (faqe 3)

Përfaqësues të organizatës "Olof Palme" nga Suedia vizituan SBASHK-un

Miqtë suedez treguan interesim të madh për organizimin dhe angazhimet e SBASHK-ut



Puna e përkushtuar në shërbim të anëtarësisë, uniteti dhe arritjet e vazhdueshme të ". ... (faqe 6)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Të gjithë e bashkë në shërbim të arsimit dhe përparimit të shtetit



Tani kur në të gjitha institucionet e Arsimit Parauniversitar të Kosovës po fillon një betejë e re e me plot sfida për arritjen e diturive të reja dhe për edukimin e arsimimin sa më cilësor të brezave është momenti kur, krahas urimeve, duhet dërguar një mesazh e apel të qartë drejtë mësimit, nxënësve, prindërve dhe liderëve e subjekteve politike të nivelit lokal e qendror që të gjithë e bashkë të jemi në shërbim të arsimit dhe përparimit të shtetit të Kosovës.

As mësuesi, as prindi, as nxënësi e as kushdo tjetër nuk mund të dalë fitues i vetëm karshi sfidave dhe kërkesave të kohës për arsimim sa më cilësor e për dije të shekullit 21. Misionin e shenjtë të edukimit e arsimimit nuk mund ta realizojmë as duke u kritikuar e fyer pa fakte, por duke u

bashkuar në frontin e përbashkët e me qëllimin e përbashkët e të sinqertë për arritje edhe më të mëdha në tërë sistemin arsimor të Kosovës.

SBASHK-u duke drejtuar këtë apel publik dhe këtë urim për një vit të mbarë shkollor u drejtohet edhe deputetëve e liderëve të subjekteve politike që të kenë kujdes fjalorin në paraqitjet publike dhe në rrjetet sociale . Të kenë kujdes edhe në sjelljet e tyre publike dhe në Parlamentin e Kosovës sepse , jo pak nga ata , me paraqitje e fjalor që nuk përkon me figurën e të zgjedhurit dhe përfaqësuesit të popullit , po krijojnë ndjenjë e mungesës së një të ardhme më të mirë për popullin e Kosovës dhe po ndikojnë me fjalorin e rënd e banal edhe në keq edukimin e brezave të ri. Ata në takime të mbyllura le të sjelljen e le të shprehen si të duan është çështje e kulturës së tyre, por në paraqitjet publike duhet të kenë kujdes sepse populli dhe rina jonë në veçanti i kanë sytë në ta. Obligim i përfaqësuesve të popullit është të punojnë në shërbim të qytetarëve dhe të arsimit e sektorëve të tjerë e jo të bëjnë gara se kush e ka fjalorin më ofendues e më banal.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë , mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)
përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me edukatoren dhe sindikalisten Flora Shabanaj

SBASHK-u të vazhdojë me angazhimet dhe sukseset



Flora Shabanaj është edukatore në Institucionin parashkollor “Foleja”.

“Duke u nisur nga fakti se fëmijëria e hershme është faza me e rëndësishme e zhvillimit të fëmijët gjatë gjithë jetës, atëherë profesioni i edukatores është pikënisje për zhvillimin e

potencialeve të fëmijëve”, thotë Flora lidhur me rëndësinë në shoqëri të profesionit të edukatores. Ajo vlerëson lart angazhimet dhe arritjet e SBASHK-ut dhe apelon te koleget e saj që të angazhohen edhe më shumë në aktivitetet sindikale.

Arsimimi sot:

Kush është Flora Shabanaj?

Flora:

Jam edukatore ne Institucionin Parashkollor “Foleja” ne Vushtrri. Kam të përfunduar shkollën fillore ne Vushtrri ,Shkollën e Mesme të Mjekësisë në Mitrovicë, Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjilan, drejtimi parashkollor dhe Fakultetin e Edukimit-drejtimi Parafillor.

Gjatë gjithë kohës sa jam punuar në këtë profesion kam kryer shumë trajnime të ndryshe të cilat kanë ndikuar në aftësimin tim në aspektin profesional dhe gjithashtu në ngritjen në karrierën time si edukatore. Po veçoj disa nga trajnimet e kryera me sukses:

Trajnimi për edukatore mentore, trajnuese e edukatoreve Mentore, Trajnimi Hap pas Hapi , Standardet e Zhvillimit,Zhvillimi i Kurikules Bërthamë të Kosovës si dhe shumë trajnime te tjera.

Arsimimi sot:

Sa mendoni se ka përgjegjësi profesioni juaj në zhvillimin e brezave të ri?

Flora:

Duke u nisur nga fakti se fëmijëria e hershme është faza me e rëndësishme e zhvillimit të fëmijët gjatë gjithë jetës, atëherë profesioni i edukatores është pikënisje për zhvillimin e potencialeve të fëmijëve në mënyrën edukative-arsimore.

Gjatë kësaj kohe asnjë nga thesaret e zhvilluara te potencialit të fëmijëve nuk guxon pa u zhvilluar andaj mund te themi është mjaft sfidues dhe llogaridhënës.

Arsimimi sot:

Sa vite keni që punoni këtë profesion dhe çfarë do të ndryshonit në të mirë të fëmijëve?

Flora:

Profesionin e edukatores e punoj afërsisht qe 30 vite. Gjate kësaj përvoje si edukatore, duke u bazuar ne planin qe e kemi nga Ministria, nuk do të ndryshoja asgjë, përveç që të uroj të kem shëndetin, vullnetin dhe të jem gjithherë model dhe përkrahëse e këtyre fëmijëve sepse krenohem me gjeneratat qe kanë dalë shumë të suksesshme dhe janë shembuj të mirë të arritjeve në shumë profesione.

Arsimimi sot:

Çka i mungon çerdheve në komunën tuaj?

Flora:

Objekti i çerdhes posedon mjaftueshëm dhoma mirëpo duke u bazuar në Planet e programet e reja për realizimin e rezultatit të kompetencës mendoj se një aneks i veçantë për grupin parafillor do të ndihmonte dhe do të lehtësonte punën edukative në grupet parafillore.

Arsimimi sot:

Aktiviteti juaj sindikal ?

Flora:

Aktiviteti im sindikal është i më hershëm. Duke parë se pushtetit në këtë sektor i duhet një oponencë e fuqishme për të ndryshuar qëndrimin e punëdhënësit ndaj të punësuarit ne respektimin me dinjitet të të drejtave personale dhe kolektive sipas ligjit për organizim sindikal dhe konventave ndërkombëtare te punës më zgjedhën në krye te organizatës sindikale për t'i adresuar çështjet që janë me interes te punonjëseve si ngritjen e pagës, të drejtat ne pune dhe marrëdhëniet e punës. Shpresoj se me aktivitetin tim dhe me ndihmën e kolegëve kemi arritur ta rrisim mirëqenien dhe te krijojmë siguri ne vendin e punës.

Arsimimi sot:

Në cilat çështje SBASHK-u duhet të fokusohet më shumë ?

Flora:

SBASHK -u duhet të angazhohet më shumë në edukimin sindikal, jo vetëm të kryetarëve, por edhe të tërë anëtarësisë e posaçërisht në teknikat e negocimit , si element ky i rëndësishëm në dialog e angazhime të suksesshme karshi DKA-ve e në përpjekje për realizimin e objektivave të anëtarësisë sindikale.

Në planin kombëtar duhet të fokusohemi më shumë në implementimin e Kontratës Kolektive. Mendoj se pagat, deri tani të ndryshuara mbi bazën e përvojës dhe kualifikimit, duhet t'iu shtohet edhe rezultati në punë, element ky , që do t'i motivonte të punësuarit të jenë gjithnjë e më të suksesshëm në punë. Besoj që për këtë çështje duhet të organizohet një debat për të gjetur formulën e duhur.

Arsimimi sot:

Si e shihni femrën si edukatore dhe sindikaliste?

Flora:

Femra është e pashmangshme në aktivitetin sindikal aq më shumë duke iu referuar përbindës së saj si e punësuar në sistemin e arsimit. Të kujtoj se femra në Kosovë, përveç si edukatore e suksesshme është

dëshmuar edhe si menaxhere e dalluar. Pra pa të, pa femrën as sindikata nuk ka kuptim .

Arsimimi sot:

Sipas jush, a është mjaft aktive femra në aktivitetet sindikale?

Flora:

Po është edhe mjaft aktive, por duhet dhënë hapësirë dhe të ngarkohet me përgjegjësinë sindikale. Kolegët tanë sindikalistë duhet të shtojnë besimin ndaj kolegeve të tyre dhe t'u besojnë më shumë angazhime e aktivitete sindikale. Le të organizohet në tryezë apo ndonjë aktivitet tjetër sindikal dhe do të binden të gjithë në dijen dhe sukseset që do të arrinin në femrat.

Arsimimi sot:

A keni diçka për të shtuar ?

Flora:

Apeloj që SBASHK-u të vazhdojë punën dhe aktivitetin ashtu si kanë vepruar edhe e deri tani me qëllim edhe të përmirësimit të vazhdueshëm të drejtave të punëtorëve të arsimit dhe në krijimin e kushteve edhe më të mira të punës në mënyrë që ne të realizojmë edhe më mirë misionin tonë të shenjtë për arsimimin dhe edukimin e fëmijëve.

Gjatë muajit

Punëtori 3 ditore e Këshillit Drejtues të SBASHK-ut

Detyra konkrete të angazhimit në shërbim të anëtarësisë

Me qëllim që të bëhen përgatitje sa më të mira për t'u përballur me sfidat dhe të konkretizim të detyrave dhe angazhimeve në shërbim të anëtarësisë Këshilli Drejtues në një punëtori tri ditore ka punuar në përgatitjen e një plani të aktivitetit lidhur me hapat konkret që duhet ndërmarrë në realizimin në plotëni të Kontratës Kolektive të Arsimit dhe të ndërrimeve e plotësimeve në Statut.

Duke hapur punimet e kësaj punëtorie kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj ka apeluar të anëtarët e Këshillit Drejtues, që ashtu si gjithmonë, edhe tani e tutje , t'i qasen me seriozitetin më të madh temave konkrete për të dhënë kontribut në përgatitjen e një plani të detajizuar të veprimtimit. Pas kësaj është kaluar në analizimin nën nën të Kontratës së Arsimit të Kosovës, që është nënshkruar nga MASHT

dhe SBASHK më 18 prill 2017, Kjo është bërë me qëllim që të dihen qartë angazhimet e nivelit komunal të organizimit sindikal dhe ato të nivelit qendror.



Duke u ndalur veçmas të neni 35 i kësaj Kontrate është saktësuar edhe një herë se çështja e

me dialog të gjendet zgjidhje për këto kërkesa. Po ashtu Këshilli Drejtues në planin e aktiviteteve në vijim ka nënvizuar se me të formuar të organeve qendrore të pushtetit do të nisin bisedat dhe dialogu lidhur me Projektligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta dhe për Ligjin mbi sigurimet shëndetësore.



Anëtarët e Këshillit Drejtues kanë qenë mjaft të angazhuar dhe kanë kontribuar edhe lidhur me ndryshimet e plotësimet në Statutin e SBASHK-ut. Këtë pjesë të punëtorisë e ka udhëhequr kryetari i Komisionit Statutar, Ymer Ymeri bashkë me anëtarët e këtij komisioni Bardh Bardhi e Besnik Krasniqi. Ata kanë hapur debatin lidhur me plotësim-ndryshimet mundura në Statutin e SBASHK-ut e me qëllim, siç thanë ata, që këto ndryshime të ndikojnë në shtimin e funksionalitetit të sindikatës sonë e në shërbim të anëtarësisë. Shumë nga anëtarët e Këshillit Drejtues

me diskutime konkrete janë mundur të japin kontributin e tyre në këtë angazhim. Nga pikat që kanë zgjuar debat ishin çështja e zvogëlimit të numrit të anëtarëve të kryesisë qendrore të SBASHK-ut nga 9 në 7 duke shkuar tutje me idenë që SBASHK-u të ketë kryesinë e ngushtë, që do të jetë e angazhuar me orar të plotë në angazhimet sindikale në SBASHK dhe kryesinë e zgjeruar, që do të mundësonte përfaqësimin e të tri niveleve arsimore. Është përmendur edhe ideja që kryetari i SBASHK-ut të ketë të drejtën që të nominojë kandidatët për kryesi, nominime të cilat pastaj do t'i votonte Këshilli Drejtues. Kjo ide është arsyetuar me faktin se kryetari duhet të ketë mundësinë të zgjedh persona që konsideron se kanë aftësi të kryejnë detyrat e nivelit qendror dhe se do të ketë mundësi të bashkëpunojë me ta në shërbim të kryerjes së detyrave e angazhimeve në shërbim të anëtarësisë.

Në përfundim të kësaj pjese të punëtorisë është marrë vendim që propozimet e dhëna nga Këshilli Drejtues t'i analizojë me kujdes Komisioni Statutar dhe bashkë me propozimet që vijnë nga shoqatat sindikale e individët, anëtarë të SBASHK-ut, të përgatiten dhe të prezantohen në Kongresin VII me qëllim që delegatët e këtij Kongresi të vendosin për këto çështje dhe për plotësimet e ndryshimet që meritojnë të bëhen në Statutin e SBASHK-ut.

Vit i suksesshëm zgjedhor në SBASHK Pas zgjedhjeve në shoqata nisi agjenda e zgjedhjeve në nivel komunash

Sipas raporteve të dorëzuara në selinë e SBASHK-ut dhe bazuar në raportimet e kryetarëve të SAF e SAM nga Komunitat e Kosovës vërehet se në përgjithësi janë kryer me sukses zgjedhjet nëpër shoqatat sindikale të institucionet të Arsimit Parauniversitar në të gjitha komunat e Kosovës. Kryerja me sukses e këtij angazhimi ka hapur mundësinë që të startohet me pjesën e dytë të agjendës zgjedhore e që ka të bëjë me zgjedhjet e organeve udhëheqëse dhe komisioneve gjegjëse e delegatëve për Kongresin VII të SBASHK-ut në Kuvendet e SAF e SAM nëpër komunat e Kosovës.

Në nismë të realizimit të kësaj agjende Kuvendi i SAF e SAM për komunën e Vushtrrisë ka mbajtur takim zgjedhor duke rizgjedhur për kryetar kolegun Alush Maloku. Ky Kuvend ka zgjedhur edhe nënkryetarin, anëtarët e kryesisë, Komisionin mbikëqyrës dhe delegatët nga arsimi i kësaj komune

për Kongresin e SBASHK-ut.



Për të pasur koordinim të plotë me kryesinë e SBASHK-ut dhe me qëllim që në të gjitha Kuvendet zgjedhore të SAF e SAM nëpër komunat e Kosovës të mundësohet pjesëmarrja e kryetarit të SBASHK-ut dhe anëtarëve të tjerë të kryesisë, Këshilli Drejtues ka përgatitur me kohë agjendën e takimeve. Me qëllim

që Kuvendet zgjedhore të jenë për pajtueshmëri të plotë me Statutin e SBASHK-ut Këshilli Drejtues, po ashtu, ka aprovuar një rend unik të punës në Kuvendet zgjedhore dhe po ashtu edhe një formular unik që do të plotësohet nga Komisionet e zgjedhura nga anëtarët e Kuvendeve të SAF e SAM në komunat gjegjëse.

Në shërbim të informimit të plotë të anëtarësisë kudo në Kosovë po publikojmë në kuadër të këtij shkrimi edhe agjendën e shënimit konkrete lidhur me datat e takimeve të Kuvendeve zgjedhore

nëpër komunat e Kosovës.



Përfaqësues të organizatës “Olof Palme” nga Suedia vizituan SBASHK-un

Miqtë suedez treguan interesim të madh për organizimin dhe angazhimet e SBASHK-ut

Puna e përkushtuar në shërbim të anëtarësisë, uniteti dhe arritjet e vazhdueshme të SBASHK-ut kanë bërë që kjo sindikatë të gëzojë respekt edhe nga organizata e institucione ndërkombëtare, të cilat vazhdojnë të takohen me përfaqësues të SBASHK-ut për t’u njohur me angazhimet , por edhe për të parë se në cilat fusha mund të zhvillohet bashkëpunim i frytshëm . në kuadër të kësaj ka ndodhur edhe një vizitë e përfaqësuesve të lartë të organizatës “Olof Palme” nga Suedia.

Duke u dëshiruar mirëseardhje mysafirëve të nderuar, kryetari i SBASHK-ut ka prezantuar përfaqësuesit tjerë në këtë takim e pastaj ka bërë një informim të shkurtër lidhur me historikun 26 vjeçar të SBASHK-ut dhe me sfidat, angazhimet dhe arritjet e kësaj sindikate nëpër vite e dekada.



Udhëheqësi i delegacionit të “Olof Palme”, z. Jonat Anderson ka falënderuar për mikpritjen e pastaj

bashkë me kolegët e tij suedez kanë shtruar një varg pyetjesh lidhur me organizimin e SBASHK-ut dhe lidhur me angazhimet konkrete.

Kryetari i SBASHK-ut , Rahman Jasharaj bashkë me nënkryetarin Lutfi Mani, menaxherin për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri dhe asistenten dhe zyrtaren për komunikim me anëtarësinë dhe opinion, Vlora Rexhepi Berisha u janë përgjigjur pyetjeve të mysafirëve duke dhënë fakte e argumente që flasin për forcimin e vazhdueshëm dhe për arritjet e mëdha të SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë. Ata kanë veçuar se për të punuar në vazhdimësi kanë ngritur edhe Planin strategjik 2015-2019, në të cilin një vend të veçantë, si thanë ata, kanë zënë edhe çështje e aktivitete që duhen zhvilluar me qëllim të forcimit të rolit të femrës në SBASHK. Mysafirëve u janë prezantuar shifra e fakte që tregojnë se janë shënuar rezultatet e parë në këtë përpjekje , por se duhet shtuar angazhimet dhe aktivitetet konkrete për të arritur cakun me qëllim që femra në SBASHK të jetë e pranishme kudo në aktivitete sindikale, por edhe në pozita udhëheqëse n ga shoqata, niveli komunal e deri të ai qendror.

SBASHK-u pret me arsye një bashkëpunim edhe më të madh me organizatën “Olof Palme” pikërisht në shtimin e sukseseve lidhur me forcimin e rolit të femrës në SBASHK.

SBASHK forcon bashkëpunimin me Sindikatën e Pavarur të Arsimit shqiptar **Gatishmëri e dy anshme për angazhime të përbashkëta sindikale**

SBASHK-u ka bashkëpunim të shkëlqyer me shumë sindikata në Ballkan, Evropë e në tërë botën dhe koordinon angazhimet e veprimet edhe me Internacionalen Botërore të Arsimit me qëllim që të gëzojë përkrahjen e vazhdueshme në përpjekjet e pa ndalura për realizimin e kërkesave të anëtarësisë.



Në kuadër të kësaj SBASHK-u vazhdon me takime pune edhe me Sindikatën e Pavarur të Arsimit Shqiptar (SPASH) duke forcuar kështu vazhdimisht bashkëpunimin me këtë sindikatë. Në shërbim të kësaj ishte edhe takimi i punës i Këshillit Drejtues të SBASHK-ut me kryetarin e SPASH-it, Nevruz Kaptelli dhe me përfaqësues të tjerë të kësaj sindikate.

Në hapje të këtij takimi kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj ka vlerësuar lart bashkëpunimin vëllazëror me SPASH-in dhe mbështetjen e vazhdueshme që këto dy sindikata i japin njëra-tjetrës në çdo angazhim në shërbim të anëtarësisë në Kosovë dhe Shqipëri. Ai është shprehur i gatshëm që të formohen grupe pune që do të përgatitnin një plan

strategjik të përbashkët për angazhime sindikale.



Kryetari i Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë, Nevruz Kaptelli në fjalën e tij ka përgëzuar SBASHK-un për angazhimet dhe arritjet duke e quajtur këtë sindikatë si shembull fort të mirë të unitetit, përkushtimit dhe arritjeve. Ai pas kësaj ka deklaruar se SPASH do të angazhohet me tërë mundësitë që grupet e përbashkëta punese të krijojnë një plan strategjik të angazhimeve të përbashkëta , jo vetëm brenda dy shteteve, por edhe në takime ndërkombëtare duke e mbështetur njëra-tjetrën me qëllim të prezantimit sa më të denjë të të dyja sindikatave edhe në arenën ndërkombëtare sindikale . Për një gatishmëri të plotë të bashkëpunimit dhe veprimeve e angazhimeve të përbashkëta mes dy sindikatave është shprehur edhe anëtari i këshillit Kombëtar i SPASH, z. Isa Halili .

Kjo gatishmëri e dy anshme për të forcuar bashkëpunimin është e natyrshme, aq më shumë kur dihet se arsimit edhe në Shqipëri e edhe në Kosovë e kudo në Ballkan përballet me sfida të njëjta e të ngjashme dhe duke bashkëpunuar e duke përkrahur njëra-tjetrën sindikatat do të jenë më të forta në tejkalimin e sfidave të shumta.